



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.21

2005

13 prill

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---------------------------------------|---|------|
| Vendim i KM nr.142, datë 18.3.2005 | Për mandatin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit | 793 |
| Vendim i KM nr.147, datë 18.3.2005 | Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” për realizimin e shërbimit të kolaudit dhe shpërndarjes së medikamenteve e të materialeve të mjekimit | 793 |
| Vendim i KM nr.148, datë 18.3.2005 | Për lejimin e ndërmarrjes së eksport-importit “MEICO” Tiranë, që, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes (Komandës së Forcave Ajrore), të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për sigurimin e pjesëve të këmbimit dhe riparimin e helikopterëve AB 205 dhe AB 206 | 794 |
| Vendim i KM nr.157, datë 25.3.2005 | Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të Këshillit të Lartë të Arkivave..... | 795 |
| Vendim i KM nr.158, datë 25.3.2005 | Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të Komisionit Qendror të Ekspertizës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave..... | 798 |

| | | |
|---------------------------------------|---|-----|
| Vendim i KM nr.159, datë 25.3.2005 | Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave..... | 801 |
| Vendim i KM nr.160, datë 25.3.2005 | Për miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave..... | 804 |
| Vendim i KM nr.170, datë 18.3.2005 | Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Entit të Turizmit..... | 807 |
| Vendim i KM nr.171, datë 11.2.2005 | Për miratimin e strategjisë kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat e trafikimit, dhe për një shtesë në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”..... | 808 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Enkeleid Gjuzi..... | 824 |
| | Ndreqje gabimi..... | 825 |

VENDIM
Nr. 142, datë 18.3.2005

PËR MANDATIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20 e 24 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mandatimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, me këtë përbërje:
 - Jorgji Bollano, propozuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
 - Thanas Dhimarko, propozuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Shqipërisë.
 - Orfea Dhuci, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë.
 - Sotiraq Dhamo, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë.
 - Flutura Kalemi, propozuar nga Universiteti Bujqësor, Tiranë.
 - Ylber Bezo, propozuar nga Ministri i Financave.
 - Sherif Bundo, propozuar nga Ministri i Financave.
 - Leandro Haxhi, propozuar nga Ministri i Financave.
2. Mandatin 6-vjeçar, për efekt të vazhdimësisë së Këshillit, e kanë personat:
 - Thanas Dhimarko,
 - Sotiraq Dhamo,
 - Ylber Bezo,
 - Sherif Bundo.
3. Shpërblimi mujor i drejtuesve dhe i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit llogaritet si përqindje e pagës së drejtorit të drejtorisë përkatëse në ministri, si më poshtë vijon:
 - Kryetari 30 për qind;
 - Nënkyetari 25 për qind;
 - Anëtarët 20 për qind.
4. Ngarkohet Ministri i Financave për sigurimin e mjediseve të punës dhe të pajisjeve të nevojshme për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.
5. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 147, datë 18.3.2005

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË TË PËRDORË PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR REALIZIMIN E SHËRBIMIT TË
KOLAUDIMIT DHE TË SHPËRNDARJES SË MEDIKAMENTEVE E TË MATERIALEVE
TË MJEKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë që për fondin e vet limit prej 59 087 000 (pësdhjetë e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, të miratuar në buxhetin e vitit 2005, zëri “Shpenzime korrente”, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me “Fu-Farma” sh.a., për realizimin e shërbimit të kolaudimit dhe të shpërndarjes së medikamenteve e të materialeve të mjekimit, për institucionet e kujdesit shëndetësor që ka në varësi.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr. 148, datë 18.3.2005

PËR LEJIMIN E NDËRMARRJES SË EKSPORT-IMPORTIT “MEICO” TIRANË, QË, PËR LLOGARI TË MINISTRISË SË MBROJTJES (KOMANDËS SË FORCAVE AJRORE) TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR SIGURIMIN E PJESËVE TË KËMBIMIT DHE RIPARIMIN E HELIKOPTERËVE AB 205 DHE AB 206

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ndërmarrjes së eksport-importit “Meico” Tiranë, që, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes (komandës së Forcave Ajrore) të përdorë për fondin limit prej 36 780 100 (tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e njëqind) lekësh, procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “Agusta” S.p.A, Itali për sigurimin e pjesëve të këmbimit dhe për riparimin e helikopterëve AB 205 dhe AB 206 të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pasqyrës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

**PASQYRA PËRMBLEDHËSE PËR MIRËMBAJTJEN DHE RIPARIMIN E
HELIKOPTERËVE**

| Nr. | Emërtimi | Tipi i helikopterit | Sasia e helikopterëve | Vlefte në lekë |
|-----|---|---------------------|-----------------------|----------------|
| 1. | Pjesë këmbimi | AB-206 | 7 | 18 000 000 |
| 2. | Pjesë këmbimi | AB-205 | 2 | 7 000 000 |
| 3. | Abonime në manuale dhe buletine teknike | AB-205 | 2 | 1 412 500 |
| 4. | Zbatim i buletinit teknik Alison 271 | AB-206 | 7 | 4 583 500 |
| 5. | Zbatim i buletinit teknik Alison 283 | AB-206 | 7 | 262 500 |
| 6. | Riparim i helikopterëve me defekt | AB-206 | 2 | 55 521 600 |
| | Shuma | | | 36 780 100 |

Shënim: Llogaritjet janë bërë sipas ofertës në euro me kursin mesatar 1 euro/125 lekë.

**VENDIM
Nr. 157, datë 25.3.2005**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË
KËSHILLIT TË LARTË TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Lartë të Arkivave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Rregullorja e Këshillit të Lartë të Arkivave, miratuar me vendimin nr.398, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave “Për miratim rregulloresh”, shfuqizohet.
 3. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Këshilli, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

RREGULLORE
PËR KËSHILLIN E LARTË TË ARKIVAVE

Neni 1
Baza ligjore

Këshilli i Lartë i Arkivave (më tej: KLA) formohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (më tej: DPA), në mbështetje të nenit 14 pika 1 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2004 “Për arkivat”.

Neni 2
Përkufizim

KLA është organizëm ndërinstitucional vendimmarrës. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3
Përbërja e KLA-së

KLA-JA përbëhet nga 17 anëtarë, 8 të brendshëm dhe 9 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë përfaqësuesit e zgjedhur nga radhët e specialistëve dhe të punonjësve të rrejtit arkivor shtetëror që administrohet nga vetë DPA-ja. Anëtarë të jashtëm të KLA-së janë ata që përfaqësojnë institucione të tjera, të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 4
Anëtarët e brendshëm të KLA-së

Anëtarët e brendshëm të KLA-së caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, me propozim dhe të Drejtorit të Drejtorisë së Inspektim-Kontrollit dhe të zëvendës drejtorit të Arkivit Qendror Shtetëror (më tej AQSH).

Drejtorët e drejtorive të DPA-së janë anëtarë të KLA-së për shkak të detyrës.

Në zgjedhjen e anëtarëve të brendshëm të KLA-së, ruhen përpjesëtimet e përfaqësimit në shkallë qendrore dhe vendore, në raportin 3 me 1.

Neni 5
Anëtarët e jashtëm të KLA-së

Anëtarët e jashtëm të KLA-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si më poshtë:

- Tre përfaqësues të Akademisë së Shkencave ose të institucioneve në varësi të saj;
- Dy përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe/ose të institucioneve në varësi të saj;
- Dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës;
- Dy përfaqësues të arkivave të sistemit. Këta të fundit zgjidhen me votim të fshehtë, nga mbledhja e drejtorëve të tyre.

Neni 6
Shpallja e përbërjes

Përbërja e KLA-së shpallet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, pas zgjedhjes së anëtarëve të brendshëm dhe caktimit të anëtarëve të jashtëm.

Mbledhja e parë e KLA-së bëhet jo më vonë se një muaj nga data e shpalljes së përbërjes nominale të tij. Në mbledhjen e parë bëhet zgjedhja e sekretarit.

Neni 7
Kryetari

Kryetar i KLA-së është Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës të mbledhjes së KLA-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e saj.

Neni 8
Sekretari

Sekretari i KLA-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtar i KLA-së që ka specializim në fushë të arkivave dhe ushtron funksionin e inspektorit të përgjithshëm pranë DPA-së. Sekretari ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KLA-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

Neni 9
Mbledhja e KLA-së

Mbledhja e KLA-së mbahet kur është e pranishme shumica e anëtarëve dhe jo më pak se tri herë në vit.

Rendi i ditës dhe aktet për diskutim vihen në dispozicion të anëtarëve të KLA-së jo më vonë se një javë para datës së mbledhjes.

Rendi i ditës hartohet nga sekretari i KLA-së dhe miratohet nga kryetari. Procesverbali i mbledhjes mbahet sipas ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16.

Një e treta e anëtarëve të KLA-së kanë të drejtë të kërkojnë thirrjen e mbledhjes së KLA-së.

Çdo anëtar i KLA-së ka të drejtë të bëjë propozime për ndryshime e shtesa në rendin e ditës. Propozimet miratohen apo/ose kundërshtohen me votimin e shumicës së thjeshtë të pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 10
Vlefshmëria e vendimmarrjes

Vendimet e KLA-së janë të vlefshme nëse fitojnë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Votimi kundër i anëtarit të KLA-së duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim.

Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 11
Detyrat e KLA-së

KLA miraton paraprakisht të gjitha aktet që kanë të bëjnë me strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të shërbimit arkivor dhe ua propozon për miratim përfundimtar, kur e kërkon ligji, organeve më të larta.

KLA harton dhe shqyrton paraprakisht projektaktet ligjore dhe nënligjore që DPA u propozon institucioneve ligjvënëse dhe ekzekutive për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor kombëtar.

KLA miraton paraprakisht rregulloret që hartohen në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” që DPA i propozon Këshillit të Ministrave për miratim:

- a) Rregulloren e Këshillit të Lartë të Arkivave;
- b) Rregulloren e Komisionit Qendror të Ekspertizës;

c) Rregulloren e Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”;

d) Rregulloren e Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve të vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare.

KLA miraton “Listën tip të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare”, të njësuar në shkallë vendi.

KLA miraton rregullat tekniko-profesionale dhe metodologjike të punës me dokumentet (administrative, tekniko-shkencore, në figurë, në zë, në lëvizje, në formë të numerizuar).

KLA miraton programet e kualifikimit profesional të punonjësve të shërbimit arkivor kombëtar.

KLA miraton raportin e analizës vjetore të DPA-së.

KLA shqyrton dhe miraton paraprakisht projektbuxhetin vjetor të DPA-së.

KLA miraton projektet botuese të DPA-së, kur kjo e fundit paraqitet si ent botues.

KLA miraton marrëveshjen tip të bashkëpunimit me institucionet e ngjashme me jashtë, në përputhje me ligjin nr.8371, datë 8.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

Neni 12

Kohëzgjatja e mandatit

Anëtarët e KLA-së zgjidhen/emërohen për një periudhë trevjeçare me të drejtën e rizgjedhjes.

Në përfundim të mandatit të KLA-së përcaktohet përbërja e re, sipas përshkrimit në nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje.

Mandati i anëtarëve të KLA-së mbaron nga mospjesëmarrja pa arsye në dy mbledhje radhazi.

Neni 13

Shpërblimi

Anëtarët e KLA-së, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 14 pika 1 dhe 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje në masën 5 mijë lekë. Kryetari shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje.

Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje.

VENDIM

Nr. 158, datë 25.3.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT QENDROR TË EKSPERTIZËS, PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Komisionit Qendror të Ekspertizës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Rregullorja e Komisionit Qendror të Ekspertizës, miratuar me vendimin nr.398, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave “Për miratim rregulloresh”, shfuqizohet.

3. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE

PËR KOMISIONIN QENDROR TË EKSPERTIZËS

Neni 1

Baza ligjore

Komisioni Qendror i Ekspertizës (më tej KQE) formohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (më tej DPA) në mbështetje të nenit 14 pika 1, 3 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Neni 2

Përkufizim

KQE është organizëm ndërinstitucional vendimmarrës. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3

Përbërja e KQE-së

KQE-ja përbëhet nga 15 anëtarë, 7 të brendshëm dhe 8 të jashtëm. Anëtarët e brendshëm janë specialistë me përvojë në fushën e arkivistikës, në rrjetin arkivor që administrohet nga DPA-ja. Anëtarë të jashtëm të KQE-së janë punonjës shkencorë e specialistë të institucioneve të tjera, të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 4

Anëtarët e brendshëm të KQE-së

Anëtarët e brendshëm të KQE-së caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Ata përzgjidhen nga arkivistët që kanë përvojë pune në shërbimin arkivor mbi 10 vjet.

Neni 5

Anëtarët e jashtëm të KQE-së

Anëtarët e jashtëm të KQE-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë si më poshtë:

- Një përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Një përfaqësues i Institutit të Statistikës;
- Një përfaqësues i Arkivit Qendror Teknik;
- Një përfaqësues i Arkivit Qendror të Filmit;
- Dy përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe/ ose institucioneve në varësi të saj.
- Dy përfaqësues të arkivave të sistemit, që zgjidhen nga mbledhja e drejtorëve të tyre, me votim të fshehtë.

Neni 6
Shpallja e përbërjes

Përbërja e KQE-së shpallet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, pas zgjedhjes/emërimit të anëtarëve të jashtëm dhe atyre të brendshëm.

Mbledhja e parë e KQE-së bëhet jo më vonë se një muaj nga data e shpalljes së përbërjes.

Neni 7
Kryetari

Kryetari i KQE-së është Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës dhe drejton mbledhjet e KQE-së.

Neni 8
Sekretari

Në mbledhjen e parë bëhet zgjedhja e sekretarit. Sekretari zgjidhet me dy të tretat e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Për funksionin e sekretarit kandidojnë vetëm anëtarët e brendshëm të KQE-së, që ushtrojnë detyrën e inspektorit të përgjithshëm.

Sekretari drejton mbledhjet e KQE-së në mungesë dhe me urdhër të kryetarit.

Neni 9
Mbledhja e KQE-së

KQE mbledhet kur është e pranishme më shumë se gjysma e anëtarëve.

KQE mbledhet jo më pak se një herë në vit.

Rendi i ditës dhe materialet e mbledhjes vihen në dispozicion të anëtarëve të KQE-së jo më vonë se dhjetë ditë para mbledhjes.

Rendi i ditës propozohet nga sekretari dhe miratohet nga kryetari i KQE-së. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga sekretari i KQE-së.

Materialet e mbledhjes shoqërohen me relacion shpjegues. Në mbledhjet kur KQE-ja ushtron kompetencat e parashikuara në nenin 11/2 të kësaj rregulloreje merr pjesë përfaqësuesi i institucionit fondkrijues.

Një e treta e anëtarëve të KQE-së kanë të drejtë të kërkojnë thirrjen e mbledhjes së KQE-së.

Çdo anëtar i KQE-së ka të drejtë të bëjë propozime për ndryshime e shtesa në rendin e ditës, të cilat miratohen apo/ose kundërshtohen me shumicën e thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 10
Vlefshmëria e vendimmarrjes

Vendimet e KQE-së janë të vlefshme nëse fitojnë shumicën e thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhjen e saj. Vendimet e KQE-së firmosen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Votimi kundër i anëtarit të KQE-së duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim.

Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 11
Detyrat e KQE-së

1. KQE përgatit "Listën-tip" të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (më tej RHK).

2. KQE miraton listat e dosjeve të veçuara për asgjësim nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore që i dorëzojnë dokumentet pranë Arkivit Qendror Shtetëror, për dokumentet që kanë humbur vlerën e ruajtjes të mëtejshme.

3. KQE miraton listat e dokumenteve të veçuara për asgjësim nga Arkivi Qendror Shtetëror. Vendimet e KQE-së u dërgohen institucioneve përkatëse dhe zbatimi i tyre ndiqet nga AQSH.

Neni 12
Shpërblimi

Anëtarët e KQE-së, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 14 pika 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje, në masën 5 mijë lekë. Kryetari shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje.

Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje.

VENDIM
Nr. 159, datë 25.3.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË DEKLASIFIKIMIT DHE TË ZHVLERËSIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”, PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së organizimit e të funksionimit të komisionit të deklasifikimit dhe të zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
E KOMISIONIT TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” QË RUHET NË ARKIVAT NË VARËSI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE TË SHQIPËRISË

Neni 1
Baza ligjore

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (më tej DPA) krijohet dhe funksionon Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” (më tej KDZH). Krijimi i këtij organizimi mbështetet në:

1. Ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.
2. Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 14 pika 1.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.124, datë 15.3.2001 “Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar”.

Neni 2 **Përkufizim**

KDZH-ja është organizëm vendimmarrës pranë DPA-së. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3 **Përbërja e KDZH-së**

KDZH përbëhet nga pesë anëtarë.

Kur fondkrijuesi i dokumenteve është subjekt-institucion në veprim, një anëtar i KDZH-së mund të jetë përfaqësuesi i certifikuar i këtij të fundit.

Në rastet kur fondkrijuesi nuk ekziston më dhe/ose e ka pushuar veprimtarinë, nëse KDZH e gjykon të domosdoshme, në mbledhje ftohet për të marrë pjesë me cilësinë e ekspertit një specialist i jashtëm i certifikuar që njih veprimtarinë e fondkrijuesit.

Në rastet e përshkruara në paragrafin e dytë të këtij neni, numri i anëtarëve të KDZH, punonjës të DPA, është katër.

Neni 4 **Anëtarët e KDZH-së**

Anëtarët e KDZH-së emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë përsëritjeje të mandatit. Përbërja e KDZH-së i bëhet e ditur Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më tej DSIK).

Neni 5 **Kryetari**

Kryetar i KDZH-së është Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari drejton mbledhjet e KDZH-së, miraton rendin e ditës e nënshkruan vendimet e saj.

Neni 6 **Nënkryetari**

Nënkryetar i KDZH-së është zëvendësdrejtori i Arkivit Qendror Shtetëror (me tej AQSH). Detyrat e nënkryetarit të KDZH janë:

Nënkryetari i KDZH-së gëzon të gjitha të drejtat e anëtarit të KDZH-së.

Nënkryetari propozon plotësimin e përbërjes/anëtarësisë së KDZH-së me përfaqësues të institucionit fondkrijues, kur ky është institucion në veprim; ose me specialistë të një fushe të përafërt të fondkrijuesit, kur ky e ka pushuar veprimtarinë dhe/ose nuk ekziston më.

Nënkryetari kërkon nga drejtuesit e arkivave shtetërore vendore në varësi të DPA-së të dërgojnë listat e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, që kanë hyrë dhe ruhen në këto arkiva.

Nënkryetari i dërgon DSIK-së bibliografinë e plotë të informacionit të deklasifikuar dhe vendimin përkatës. Një kopje e kësaj bibliografie i jepet sektorit të komunikimit në DPA. Bibliografia e informacionit të deklasifikuar disponohet lirisht nga kërkuesit.

Neni 7 **Sekretari**

Funksionet e sekretarit të KDZH-së i kryen një nga anëtarët e këtij organizmi, që është punonjës i sektorit përkatës të dokumenteve me informacion të klasifikuar, objekt deklasifikimi i mbledhjes së KDZH-së.

Sekretari i KDZH-së përgatit materialin e mbledhjes dhe mban procesverbalin e saj. Sekretari nënshkruan aktet e vendimmarrjes dhe bibliografinë.

Sekretari i KDZH-së bën vlerësimin e drejtpërdrejtë të dokumentit, objekt deklasifikimi, në rastet kur nuk është e mundur të merret vendim duke u mbështetur vetëm në të dhënat përshkrimore të dokumenteve (inventarë, skedarë). Vlerësimi i tij i paraqitet KDZH-së në mbledhjen me të afërt.

Sekretari i KDZH-së përgjigjet për kalimin në ambientet e sigurisë së lartë të informacionit të klasifikuar që KDZH-ja vendos të mos e deklasifikojë. Vendosja e dokumenteve që mbeten të klasifikuara në mjedisin e sigurisë së lartë bëhet brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

Sekretari i KDZH-së vendos shenjën e deklasifikimit, në formë të pandryshueshme e të dukshme, mbi dokumentin që nuk bart më shkallë klasifikimi, në përputhje me vendimin. Ai bën ndryshimet përkatëse në mjetet e informacionit dhe të kërkimit arkivor.

Përgjegjësi i sektorit të komunikimit të AQSH-së informon rregullisht sekretarin e KDZH-së për kërkesat e paraqitura nga subjekte publike e private për dokumente që përmbajnë informacion të klasifikuar.

Sekretari i KDZH-së mund të propozojë deklasifikimin e dokumenteve objekt kërkimi të studiuesve jashtë radhës kronologjike.

Sekretari i KDZH-së jep sqarimet ligjore për kërkuesin që i refuzohet shërbimi për rastet kur dokumentet ende nuk janë deklasifikuar. Ai mbron vendimin e KDZH-së në rastin e ankimit të tij në gjykatë, prej personave të interesuar.

Dokumentet që përmbajnë informacion të deklasifikuar janë dokumente të hapura, të shërbyeshme lirisht për kërkuesit, përveç rasteve kur ka pengesa të tjera të parashikuara në nenet 61 pika 2, 63, 64 dhe 65 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

Neni 8 **Mbledhja e KDZH-së**

KDZH-ja mblidhet kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit. Në rastet kur fondkrijuesi është institucion në veprim, KDZH-ja mblidhet duke qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i certifikuar i fondkrijuesit. Në rastet kur KDZH-ja fton specialistë të jashtëm për të ndihmuar vendimmarrjen, vlerësimi i tyre paraqitet me shkrim.

KDZH-ja mblidhet jo më pak tri herë në vit.

Radha e shqyrtimit për vendimmarrje në KDZH të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar si rregull është kronologjike, duke nisur prej fondkrijuesve më të rëndësishëm. Në rast të evidentimit të kërkesave specifike të studiuesve, KDZH-ja mund të bëjë deklasifikim jashtë rendit kronologjik.

Për përgatitjen e lëndës dhe të akteve të mbledhjes së KDZH-së mund të ngarkohen edhe specialistë të tjerë të certifikuar të AQSH-së.

Neni 9 **Vlefshmëria e vendimmarrjes**

Vendimet KDZH-së janë të vlefshme vetëm nëse votohen unanimisht.

Anëtari i KDZH-së ka të drejtë të ushtrojë votën e vet pro ose kundër. Votimi kundër i anëtarit të KDZH-së bëhet me shkrim.

Nëse një dokument që deklasifikohet nga KDZH-ja gjendet edhe në arkiva të tjera në varësi të DPA-së, vendimi është i vlefshëm edhe për këto arkiva.

KDZH-ja bën publike vendimmarrjen pas konfirmimit nga DSIK-ja.

Neni 10

Detyrat e KDZH-së

KDZH-ja është organizëm vendimmarrës për deklasifikimin e dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, të trashëguara me këtë status në kohën e pranimit në AQSH ose në arkivat shtetërore vendore.

KDZH-ja zbaton në veprimtarinë e vet aktet ligjore në fuqi dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.124, datë 15.3.2001 “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”.

Neni 11

Shpërblimi

Anëtarët e KDZH-së, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, neni 14 pika 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje në masën 5 mijë lekë. Kryetari shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje.

Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje.

VENDIM

Nr. 160, datë 25.3.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË EKSPERTËVE, PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 94 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit e të funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe çdo efekt tjetër financiar që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

RREGULLORE
PËR KOMISIONIN E PËRHERSHËM TË EKSPERTËVE

Neni 1
Baza ligjore

Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve për vlerësimin e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (më tej Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve-KPE) formohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë (më tej DPA), në mbështetje të nenit 14 pika 1 dhe 5 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Detyrat e KPE-së burojnë nga neni 31 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Neni 2
Përkufizim

KPE-ja është organizëm ndërinstytucional. Përbërja, detyrat dhe funksionet e tij përcaktohen me këtë rregullore.

Neni 3
Përbërja e KPE-së

KPE-ja përbëhet nga specialistë të vlerësimit të trashëgimisë arkivistike kombëtare.

KPE-ja formohet si vijon:

- Tre anëtarë të brendshëm emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave.
- Dy anëtarë caktohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe/ose institucionet në varësi të saj.
- Dy anëtarë caktohen nga Akademia e Shkencave dhe/ose institucionet në varësi të saj.
- Dy anëtarë caktohen nga Universiteti i Tiranës.

Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave shpall përbërjen e KPE-së.

Mbledhja e parë e KPE-së bëhet jo më vonë se një muaj pas shpalljes së përbërjes së tij.

Mbledhja e parë thirret nga Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Në këtë mbledhje bëhet zgjedhja e sekretarit të KPE-së.

Kryetar i KPE-së është një përfaqësues i Akademisë së Shkencave, me titull “akademik”.

Sekretar i KPE-së është një përfaqësues i DPA-së, më përvojë pune në arkiva jo më pak se dhjetë vjet. Ai përgatit lëndën që do të shqyrtojë mbledhja dhe mban procesverbalin e saj.

Neni 4
Qëllimi

KPE-ja i ushtron përgjegjësitë e parashikuara në këtë rregullore vetëm për aktet që cilësohen “Dokumente me rëndësi historike kombëtare” (më tej RHK).

Neni 5
Detyrat

KPE-ja miraton paraprakisht:

1. “Listën tip” me afatet e ruajtjes së dokumenteve administrative RHK, që i paraqitet nga Komisioni Qendror i Ekspertizës.

2. Shpërndarjen në vendruajtje të fondeve të dokumenteve që administrohen nga DPA-ja.

Vendimet që merr KPE-ja sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni miratohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave (më tej KLA).

3. Matricën e njësuar të përshkrimit të dokumentit RHK që subjekti joshtetëror privat nxjerr në shitje.

4. Vlerësimin e kushteve të parablerjes nga DPA-ja të këtyre dokumenteve, sipas nenit 31 pika 1 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”. KPE-ja negocion për ushtrimin e kësaj të drejte nga DPA-ja. Në rast se DPA-ja nuk ka mundësi buxhetore të ushtrimit të së drejtës së parablerjes, KPE-ja jep mendimin përkatës për dhënien ose/dhe jo të lejes së tregtimit të lirë të dokumenteve RHK që subjektet joshtetërore private duan të shesin. Mendimi i përcillet DPA-së për të ushtruar të drejtën e vendimmarrjes.

5. Dërgimin dhe/ose moslejimin e nxjerrjes jashtë vendit të dokumenteve RHK në pronësi të shtetit dhe/ose të subjekteve joshtetërore private, në rast se këto dokumente përbëjnë vlera unikale në kuadër të trashëgimisë arkivore të vendit, të cilin ia përcjell Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave për bërjen e propozimit për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministirave, sipas përcaktimit të nenit 83 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

6. Kushtet e tregtimit të dokumenteve RHK në rast të ndryshimit të pronarit privat. Këto kushte KPE-ja ia propozon DPA-së për ushtrimin e së drejtës së vendimmarrjes. Kjo e fundit mund të kufizojë shitjen e këtyre dokumenteve deri në 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit prej pronarit. Kur KPE-ja nuk arrin të marrë vendim duke u mbështetur vetëm në përshkrimet arkivistike, që të propozojë ndalimin dhe/ose të kushtëzojë shitjen e lirë të dokumenteve RHK në pronësi të subjekteve joshtetërore private, ai ka të drejtë të njihet me vetë dokumentin, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj.

Pronari joshtetëror privat i dokumenteve RHK ka të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

7. Rregullat për paraqitjen e dokumenteve arkivore në mjediset ndërkombëtare, të cilat ia paraqet për miratim përfundimtar Këshilit të Lartë të Arkivave.

8. Listën e pronarëve të arkivave private, që sipas nenit 32 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura RHK.

Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave miraton vendimet e KPE-së të përshkruara në paragrafët 3, 4, 6 e 8 të këtij neni.

Neni 6

Vlefshmëria e vendimmarrjes

Vendimet e KPE-së janë të vlefshme nëse miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarve pjesëmarrës në mbledhje. Votimi kundër i anëtarit të KPE-ja duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim. Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 7

Kohëzgjatja e mandatit

Anëtarët e KPE-së caktohen për një periudhë pesëvjeçare.

Në përfundim të mandatit të KPE-së, ripërcaktohet përbërja e tij sipas përshkrimit në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Mandati i anëtarësisë në KPE është i përsëritshëm. Mandati i anëtarësisë në KPE zhvlerësohet vetvetiu nga mospjesëmarrja pa arsye në dy mbledhje radhazi.

Neni 8

Shpërblimi

Anëtarët e KPE-së, në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, neni 14 pika 5, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi për çdo mbledhje, në masën 5 mijë lekë. Kryetari shpërblehet me 7 mijë lekë për çdo mbledhje.

Shpërblimi jepet vetëm në rastet e pjesëmarrjes në mbledhje.

VENDIM
Nr. 170, datë 18.3.2005

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË ENTIT TË TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “Drejtor”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në Entin e Turizmit, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1-diplomë e shkollës së lartë – është 9 306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë.
3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.
5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.
6. Pagat e punonjësve të tjerë të jenë sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore”, të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.
7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
8. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

| EMËRTIMI | KATEGORIA | PAGA MUJORE | | | |
|------------------------|-----------|---------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------|--------------------------------|
| | | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | | Paga e grupit (PG)) | Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) lekë |
| Drejtor i Përgjithshëm | II-a | 9 306 | 2% | 0 | 93 060 |
| Drejtor | II-b | 9 306 | 2% | 0 | 76 516 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 9 306 | 2% | 0 | 41 360 |
| Specialist | IV-b | 9 306 | 2% | 0 | 20 680 |

VENDIM
Nr. 171, datë 11.2.2005

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.8, DATË 5.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit.
2. Ngarkohet Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore për ndjekjen, kontrollin dhe zbatimin e detyrave të caktuara në këtë strategji.
3. Në pikën 1 të vendimit nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave, shtohet emërtimi: “Zëvendësministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit anëtar”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**STRATEGJIA KOMBËTARE KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE
DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT**

I. Hyrje

Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka kaluar një proces të vështirë dhe kompleks tranzicioni, i cili është shoqëruar me papunësi dhe varfëri, të pandeshura më parë, lëvizje demografike të pakontrolluara brenda vendit dhe jashtë tij, dhe me një fenomen të ri, si rezultat i këtyre ndryshimeve.

Fillimisht lëvizjet masive dhe largimet drejt perëndimit u bënë si rezultat i ndryshimit të sistemit politik, nevojës për hapje të kufijve dhe një jete më të mirë. Kështu, deri në fillim të vitit 1992 pati largime masive drejt perëndimit, kryesisht drejt Greqisë e Italisë, si dy vendet më të afërta.

Pas viteve 1992, pas këtij emigracioni masiv, elementë kriminalë dhe të korruptuar filluan që të krijojnë rrugë trafikimi ilegale, nga ku siguruan fitime të mëdha. Në këtë fazë filloi dhe aktiviteti kriminal i trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë këtu trafikimin e grave dhe fëmijëve me qëllim shfrytëzimi, një fenomen thellësisht negativ në shoqërinë shqiptare, duke sjellë fitime mjaft të mëdha për trafikantët.

Përveç konflikteve të zgjatura në Ballkan, mungesës së stabilitetit të brendshëm, krimi i organizuar kombëtar dhe ndërkombëtar, rrjetet e trafikut, si dhe lëvizjet e pakontrolluara të kalimit të kufijve, e përkeqësuan fenomenin e trafikut në vend, duke sjellë një fluks të madh migrantësh të paligjshëm, duke përfshirë këtu gra dhe fëmijë nga vendet e Europës Lindore, si dhe nga vende të tjera më të largëta, si për qëllime shfrytëzimi në Shqipëri, ashtu edhe duke i transituar drejt Europës.

II. Trafiku i fëmijëve për qëllim shfrytëzimi dhe fitimi

Ndryshe nga më sipër, trafiku i fëmijëve në Shqipëri, kryesisht në vendet fqinje, është një nga fenomenet më shqetësuese dhe një nga plagët sociale më serioze, duke pasur parasysh brishtësinë e fëmijëve, dhe pasojat në dëmtime fizike dhe psikologjike në jetën e fëmijëve, si dhe për brezat e ardhshëm.

Në Shqipëri, varfëria u shoqërua me dobësim të traditës, humbje të lidhjeve familjare dhe solidaritetit të afërmëve (lidhjeve të gjakut). Këto situata rënduan në shoqërinë dhe familjen shqiptare dhe veçanërisht mbi fëmijët, të cilët janë dhe pjesa më e brishtë në një familje.

Në disa raste, abandonimi i shkollës në zonat rurale dhe lëvizja masive demografike e familjeve, veçanërisht nga zona verilindore, solli që shumë fëmijë të fillojnë të punojnë në rrugët e qyteteve të mëdha, nga ku ata u bënë viktimat të rekrutimit në aktivitete kriminale dhe në rrjete trafikimi të organizuara. Në raste të tjera, sidomos në komunitete dhe familje të përjashtuara, jo të ndërgjegjësuar për trafikimin dhe pasojat e tij, në shumë raste nxitën dërgimin e fëmijëve jashtë shtetit me besimin se atje do të krjojnë një të ardhme më të mirë, duke bërë dhe marrëveshje me të ashtuquajturit “mbrojtës”.

Burimet më të spikatura të rekrutimit të fëmijëve për trafikim janë:

- Familje të divorcuara ku mungon kujdesi familjar;
- Familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike;
- Familje fshatare me shpresë ndihme nga fëmijët;
- Fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes;
- Familje që prindërit u janë larguar për punësim jashtë shtetit;
- Fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypësi e veprimtari tjetër të kundërligjshme edhe në Shqipëri;
- Fëmijë që nuk mund të shkojnë në shkollë;
- Fëmijë të paregjistruar që në lindje;
- Familje ku të paktën një fëmijë është trafikuar edhe më parë;
- Familje me fëmijë me paaftësi mendore të trashëguar nga prindërit;
- Fëmijë të dalë nga martesat e prindërve në moshë të re.

Rrugët e trafikimit të fëmijëve zakonisht janë të njëjtat me ato të trafikimit të qenieve njerëzore, por nga trafikantët përdoren edhe dokumente të falsifikuara si kujdestarë apo prindër të tyre. Vendet e destinacionit, ku trafikohen fëmijët, janë zakonisht vendet fqinje, si Italia dhe Greqia, nga ku rrjetet e trafikut dhe grupet e organizuara kriminale shtrijnë veprimtarinë e tyre edhe në vende të tjera të Europës.

Sipas një OJQ-je ndërkombëtare, numri i fëmijëve të pashoqëruar gjatë kësaj dekade në emigracion llogariten rreth 4000, kryesisht në vendet fqinje. Ka OJF të tjera që sjellin shifra që numri i fëmijëve që janë larguar ilegalisht dhe janë shfrytëzuar për lypësi, punë fizike, dhe aktivitete të tjera të paligjshme arrin deri në 6000. Për natyrën klandestine të fenomenit, si dhe mungesën e informacionit nga vendet e destinacionit, konfirmimi i këtyre shifrave është shumë i vështirë, megjithëse fenomeni është mjaft shqetësues edhe sikur shifrat realisht të jenë më të ulëta.

III. Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, 2001-2004

Në dhjetor 2001, Qeveria shqiptare, duke e konsideruar luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe të gjitha formave të tij si një prioritet shqiptar dhe ndërkombëtar, aprovoi strategjinë kombëtare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore 2001-2004, e hartuar nga strukturat qeveritare në bashkëpunim me OJQ-të lokale dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë në fushën e antitrafikut.

Strategjia kombëtare përfshin objektiva dhe specifika në programe afatshkurtra dhe afatmesme në fushat e parandalimit dhe të mbrojtjes, ndjekjes penale dhe dënimit të trafikantëve (si dhe reformat e duhura ligjore), si dhe fushatat e ndërgjegjësimit dhe masat sociale dhe institucionale për strehimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave të trafikut.

Megjithëse trafiku i fëmijëve nuk është në fokusin kryesor të Strategjisë kombëtare, 2001-2004, strategjia dhe masat e marra në këtë kuadër njohin për herë të parë dimensionin human, social, ligjor dhe kompleksitetin institucional për luftën kundër trafikut të fëmijëve dhe riintegrimin e tyre, si dhe rëndësinë e zhvillimit social dhe ekonomik, uljen e varfërisë dhe dhënien e mundësive

të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë për të bërë të mundur shfarosjen e këtij fenomeni.

Gjithashtu në këtë strategji konstatohet se lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore kërkon një angazhim jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe të organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendase dhe OJQ-ve ndërkombëtare, që ofrojnë kapacitete dhe eksperiencë unike në këtë fushë. Një nga arritjet më të fuqishme të strategjisë është dhe institucionalizimi në një nivel më të lartë të bashkëpunimit me OJF-të vendase, OJQ-të ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe iniciativave të dyanëshme me institucionet qeveritare dhe joqeveritare të vendeve të rajonit.

Si rezultat i rritjes së punës të forcave të rendit dhe zbatimi i detyrave të strategjisë kombëtare nga koordinimi i punës i të gjitha institucioneve si qeveritare, ashtu dhe joqeveritare në fushën e ndjekjes penale, mbrojtjes dhe parandalimit, Shqipëria ka bërë një përparim të dukshëm në luftë kundër fenomenit të trafikut duke filluar qysh më 2001, jo vetëm në uljen e numrit të viktimave nga ky trafik në vend, por gjithashtu më 2002 Shqipëria nuk ka më statusin e një vendi kryesor destinacioni dhe transiti (në krahasim me origjinën).

Megjithatë, nga konstatimet e organizmave të brendshëm dhe ndërkombëtarë, në Shqipëri janë identifikuar dobësi në zbatim, të cilat vazhdojnë të kenë një ndikim negativ megjithë përpjekjet e Qeverisë shqiptare. Në këto dobësi përfshihet, krahas të tjerave, vazhdimi i emigrimit ilegal të fëmijëve në vendet fqinje, kryesisht Greqi dhe Itali, dhe mungesa e strukturave të nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse, si dhe kapacitetet për t'iu kundërpërgjigjur problemit në një mënyrë sa më efektive.

Si rezultat, në tetor 2003, Qeveria shqiptare aprovoi planin e punës antitrafik 2003-2004, brenda kuadrit të strategjisë kombëtare, një nga objektivat e të cilit ishte dhe hartimi i strategjisë për luftën kundër trafikut të fëmijëve. Në planin e punës 2003-2004 përfshihej edhe ngritja e një grupi ndërministror, brenda strukturave qeveritare për të luftuar trafikun e qenieve njerëzore, për të punuar me organizatat kombëtare, OJF-të vendase, OJQ-të ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar objektivat në kuadër të luftës kundër trafikut të fëmijëve, në të gjitha aspektet e tij.

IV. Drafti i strategjisë kombëtare dhe plani i punës për luftën kundër trafikut të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, viktimat të trafikut, 2005-2007

Kjo strategji e re nuk dublon Strategjinë kombëtare kundër trafikut të qenieve njerëzore, e cila vazhdon të zbatohet, por e shikon fenomenin e trafikimit në një këndvështrim të ri, brenda kuadrit të strategjisë kombëtare, dhe synon që të intensifikojë për këtë qëllim koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe organizmave qeveritare, ndërkombëtare dhe lokale, si dhe të OJQ-ve.

Kjo strategji u hartua nga një grup pune me specialistë nga Ministri i Shtetit për Koordinim, Ministria e Rendit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Prokuroria e Përgjithshme. Këta specialistë punuan si një grup pune "ad-hoc". Në punën e tij grupi u mbështet nga UNICEF-i dhe u ndihmua nga BKT (bashkë kundër trafikimit të fëmijëve) një rrjet shoqatash që punojnë së bashku kundër trafikimit të fëmijëve, duke përfshirë këtu edhe IOM, ILO, ICMC dhe OSCE. Gjithashtu kjo iniciativë u mbështet edhe nga Task Forca e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore (TFPC).

Në hartimin e kësaj strategjie, grupi i punës u bazua edhe në udhëzimin e UNICEF-it 2003 për mbrojtjen e fëmijëve viktimat të trafikut në Europën Juglindore, u bazua edhe në instrumentet ligjore vendas dhe ndërkombëtare, si dhe në analizat e bëra për këtë fenomen në Shqipëri nga OJQ vendase dhe të huaja.

V. Objektivat e strategjisë së luftës kundër trafikut të fëmijëve dhe plani i punës

Strategjia për luftën kundër trafikut të fëmijëve ka si qëllim përshpejtimin e iniciativave të ndërmarra për të ulur dhe ndaluar fenomenin e trafikut të fëmijëve në Shqipëri, duke intensifikuar dhe koordinuar aktivitetet e të gjitha institucioneve qeveritare, partnerëve ndërkombëtarë, OJF-ve vendase dhe OJQ-ve ndërkombëtare përmes përmbushjes së objektivave, detyrave dhe afateve kohore bashkëngjitur në planin e punës për një periudhë 2-vjeçare (2005 -2007).

Në këtë strategji dhe plan pune i është vënë prioritet identifikimit dhe ndjekjes penale të trafikantëve dhe organizatorëve përmes rritjes së përpjekjeve të forcave policore në vend dhe përgjatë kufijve, si dhe masat që do të merren për fëmijët që janë në rrezik ose që janë trafikuar, për t'i ofruar atyre ndihmë mjekësore, psikologjike, sociale dhe ekonomike.

Në këtë këndvështrim, kjo strategji e re nuk parashikon vetëm masat për një strehim të përkohshëm dhe të ngritjes së kapaciteteve për institucionet dhe punonjësit socialë, por edhe rehabilitimin afatgjatë dhe integrimin, si ndihmë familjare, zhvillimi i shërbimeve të përkujdesjes dhe birësimit, të bazuar në të drejtën që çdo fëmijë ka për t'u rritur në familje.

Gjithashtu janë parashikuar masa në lidhje me braktisjen e shkollës, punës së paligjshme për fëmijët, uljen e varfërisë dhe nevojat për trajnime profesionale, si alternativa për të ulur emigracionin e paligjshëm, trafikimin dhe ritrafikimin.

Një prioritet i është dhënë dhe masave në kuadër të ndërgjegjësimit të publikut, si nga Qeveria dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara, duke vënë theksin në zonat rurale dhe në sektorët më në nevojë të shoqërisë urbane.

Kjo strategji, gjithashtu, parashikon krijimin e një strukture të veçantë në nivel prefekturë për të koordinuar dhe monitoruar parandalimin e trafikut të fëmijëve, mbrojtjen dhe rehabilitimin, arsimimin, shërbimin shëndetësor dhe social, punën policore dhe punonjësit e pushtetit lokal. Në këtë strategji, gjithashtu, inkurajohet edhe ngritja e partneritetit në nivel lokal të strukturave qeveritare dhe joqeveritare me partnerët lokalë për të zbatuar objektivat e parashikuara në planin e punës.

Strategjia bazohet në parimin dhe bindjen që ka Qeveria shqiptare se trafiku i fëmijëve, si të gjitha format e tjera të trafikut të qenieve njerëzore, përbën krim dhe dëmton dinjitetin dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarëve, dhe është përgjegjësia kryesore e Qeverisë për ta luftuar dhe zhdukur këtë fenomen.

Në të njëjtën kohë theksohet se edhe pse Qeveria shqiptare ka dhe pranon përgjegjësinë kryesore për këtë fenomen, ashtu siç manifestohet edhe në përgjegjësitë që ajo ka marrë në draft planin e punës të strategjisë së luftës kundër trafikut të fëmijëve, përsëri është mjaft i nevojshëm dhe dobiprurës partneriteti dhe bashkëpunimi me sektorin joqeveritar, me partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë, duke marrë parasysh këtu dhe mungesën e burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe duke vlerësuar ekspertizën që këto organizata ofrojnë në fusha specifike.

VI. Struktura e planit të punës të luftës kundër trafikut të fëmijëve

Në përputhje me sa më sipër, plani i punës është hartuar sipas një strukture me katër pika, që është rënë dakord me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë:

- Parandalimi (ku përfshihet forcimi i ligjit dhe rritja e kontrollit të kufijve, rritja e ndërgjegjësimit, edukimi dhe informimi, si dhe trajnimi në nivel lokal dhe kombëtar, duke u fokusuar në komunitetet më të brishta/të prekura);

- Mbrojtja dhe riintegrimi i fëmijëve, viktimat të trafikut (ku përfshihet kuadri ligjor, forcat policore, ndjekja penale dhe procedurat ligjore);

- Kthimi vullnetar i asistuar (bazohet mbi praktikën më të mirë për identifikimin, mbrojtjen, dhe kthimin në vendin e origjinës të fëmijëve);

- Koordinimi i aktorëve (kombëtarë dhe ndërkombëtarë, qeveritarë dhe joqeveritarë, në nivel qendror dhe lokal).

VII. Parimet e përgjithshme ku bazohet strategjia e kundër trafikut të fëmijëve

- Të drejtat e fëmijës

Të gjitha veprimet e ndërmarra në lidhje me fëmijët viktimat do të udhëhiqen dhe do të jenë të bazuara në parimet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut siç është parashikuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989).

Fëmijëve viktimat u jepet e drejta të kërkojnë masa speciale për mbrojtje, si viktimat dhe si fëmijë, në pajtueshmëri me të drejtat dhe nevojat e tyre specifike.

Përfshirja e fëmijës viktimë në aktivitetet kriminale nuk duhet të cenojë statusin e tij si fëmijë dhe si viktimë.

- Interesi më i lartë i fëmijës

Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët viktimë, qofshin ato të ndërmarra nga institucionet e përkujdesjes sociale publike apo private, nga gjykatat, autoritetet administrative ose nga personat juridikë, në çdo rast detyrë parësore duhet të jetë interesi më i lartë i fëmijës.

- E drejta për mosdiskriminim

Fëmijëve viktimë u jepet e drejta të kërkojnë masa mbrojtëse dhe të drejta të njëjta si të gjithë fëmijët e tjerë, të cilët janë banorë të atij shteti. Para së gjithash ata duhet të konsiderohen si fëmijë. Të gjitha elementet rreth statusit të tyre, përkatësisë kombëtare, racës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, përkatësisë etnike ose origjinës sociale, lindjes ose ndonjë statusi tjetër duhet të jenë dytësore.

- Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës

Fëmija viktimë, e cila është në gjendje të formojë pikëpamjet e tij apo të saj, gëzon të drejtën t'i shprehë këto pikëpamje në mënyrë të qartë lidhur me çdo gjë që ka të bëjë me të, si në vendimin e tij lidhur me mundësinë e kthimit në familje ose në vendin e origjinës.

Pikëpamjeve të fëmijës duhet t'u jepet vëmendja e duhur në pajtueshmëri me moshën, në interesin më të mirë të tij, si dhe me pjekurinë e tij.

- E drejta për informim

Fëmijëve viktimë duhet t'u sigurohet informacion mbi statusin e tyre, situatën e tyre, të drejtat e tyre, shërbimet të cilat i kanë në dispozicion dhe ribashkimin e familjes dhe/ose procesin e riadhesimit.

Informacioni duhet të sigurohet në gjuhën në të cilën fëmija viktimë është në gjendje ta kuptojë. Çdo herë duhet të jenë në dispozicion përkthyes të përshtatshëm, punonjës socialë apo psikologë, kur fëmijët viktimë merren në pyetje, kur intervistohen ose në ato raste kur kërkojnë t'u ofrohen shërbime.

- E drejta e konfidencialitetit

Informacioni mbi fëmijën viktimë që mund ta rrezikojnë fëmijën ose ndonjë anëtar të familjes së fëmijës, nuk duhet të bëhen të ditura.

Duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur identitetin dhe intimitetin e fëmijës viktimë. Emri, adresa ose ndonjë informatë tjetër, e cila mund të çojë drejt identifikimit të fëmijës viktimë ose të anëtarëve të familjes së fëmijës, nuk duhet t'u bëhen të njohura mediave apo opinionit të gjerë.

Përpara se informacioni delikat të bëhet i njohur, duhet kërkuar autorizimi i fëmijës viktimë në përputhje me moshën e tij.

- E drejta për të qenë i mbrojtur

Shteti ka për detyrë që t'i mbrojtë dhe të ndihmojë fëmijët viktimë dhe t'u garantojë atyre sigurinë.

Të gjitha vendimet lidhur me fëmijët viktimë duhet të ndërmerren sa më shpejt të jetë e mundur dhe në mënyrë të duhur.

VIII. Baza ligjore ku mbështetet strategjia e trafikut kundër fëmijëve

Për qëllim të strategjisë dhe planit të punës:

- Trafikimi i fëmijës është akti i rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes ose mbajtjes së fëmijës, për qëllime shfrytëzimi si brenda shtetit, ashtu edhe jashtë tij.¹

- Shfrytëzimi përfshin shfrytëzimin për prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën apo shërbime të tjera të detyruara, skllavërinë ose praktikën e ngjashme me skllavërinë apo heqjen e organeve.

- Pajtimi i fëmijës viktimë konsiderohet si shfrytëzim i paramenduar edhe nëse nuk është përdorur njëra nga format e poshtëshënuara si "dhuna, ndonjë formë tjetër e detyrimit, e rrëmbimit, e mashtrimit, e përdorimit të forcës ose veprimeve të ndërmarra derisa njëri është në gjendje të ndjeshme ose derisa njëri është nën kontrollin e personit tjetër".

¹ Protokollin "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçan të grave e fëmijëve", nënshkruar në Palermo, dhjetor 2001

- Fëmijë viktimë e trafikimit konsiderohet cilido person nën moshën 18 vjeç.

- Fëmijë të pashoqëruar në emigracion konsiderohen fëmijët që ndodhen në emigracion të pashoqëruar nga familjet e tyre. Si të tillë ata mund të jenë më shumë të rrezikuar për t'u trafikuar.

Bazuar në strategjinë kombëtare të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe konventave përkatëse të OKB-së, si dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga Shqipëria, u bë një rishikim i legjislacionit më 2001, me qëllim rritjen e dënimit për forma të caktuara të trafikut të qenieve njerëzore, si dhe bazuar në përvojën ndërkombëtare të dallimit të viktimës nga trafikanti, ku viktimja e rritur apo fëmijë trajtohet si viktimë dhe nuk ndiqet penalisht.

Në ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal" u bënë disa ndryshime mbi veprën penale dhe dënimet në rastin e trafikut të qenieve njerëzore, trafikut të femrave për prostitucion, si dhe të trafikut të fëmijëve për qëllime shfrytëzimi.

Në të gjitha rastet, dënimi është më i madh kur viktimja është i mitur, kur shfrytëzimi është bërë nga një grup njerëzish, për qëllime fitimi apo kur është përdorur forca, ose kur vepra është kryer në mënyrë të vazhdueshme apo në bashkëpunim me të tjerët, përmes abuzimit të detyrave shtetërore, apo nga organizata kriminale të armatosura.

Kodi Penal shqiptar parashikon sanksione për vepra penale që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me trafikimin e njerëzve, femrave dhe fëmijëve. Këtu përfshihen përveç veprave penale të përmendura më lart edhe ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, shfrytëzimi, financimi dhe dhënia me qira e lokaleve për prostitucion, rrëmbimi i personit, si dhe i fëmijës, rrezikimi i jetës së personit duke e shoqëruar me vuajtje të rënda fizike ose psikologjike, rrahje, marrëdhënie seksuale me dhunë, vjedhja e dokumenteve të identifikimit, falsifikimi i dokumenteve të identifikimit, i pasaportave, i vizave etj.

Më 12 shkurt 2004, Kuvendi Shqiptar aprovoi me propozim të Këshillit të Ministrave, ligjin nr.9188 ku bëhen ndryshime dhe shtesa të metejshme të Kodit Penal në të gjitha fushat e përmendura më sipër, duke përfshirë dhe trafikun e fëmijëve. Ky ligj i ri paraqet një përkufizim të ri për veprat penale të trafikimit, sipas protokollit të Palermos, ku parashikohen dënime më të rënda, si dhe gjoba për autorët e trafikut, veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit, si dhe rritje të dënimit me një të katërtën për ata individë që ushtrojnë funksione shtetërore.

Detajet e legjislacionit të ndryshuar janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

| Neni | Vepra penale | Sanksioni |
|-------|--|--|
| 110/1 | Rekrutimi, transporti dhe mbajtja e personave përmes kërcënimit ose forcës, apo nëpërmjet formave të tjera të presionit, ose dhënia apo marrja e pagesës apo përfitimeve të tjera nga një person, i cili kontrollon një tjetër, për qëllime shfrytëzimi për prostitucion, apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, pune apo shërbime të tjera të detyruara, për qëllime të transplantit të organeve apo të formave të tjera të shfrytëzimit | 5-15 vjet burgim dhe gjobë nga 2-5 milionë lekë |
| | Organizimi, menaxhimi dhe financimi i trafikut të qenieve njerëzore | 7-15 vjet burg dhe gjobë nga 4-6 milionë lekë |
| | Në bashkëpunim me të tjerë, ose më shumë se një herë, ose kur shoqërohet me keqtrajtme duke e detyruar viktimën të veprojë përmes përdorimit të dhunës fizike apo psikologjike, ose kur shkakton dëmtime të rënda të shëndetit | Jo më pak se 15 vjet burgim dhe gjobë nga 6-8 milionë lekë |

| | | |
|-------|--|--|
| | Kur shkakton vdekjen e viktimës së trafikut Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike | Burg të përjetshëm Një e katërta shtesë e burgimit dhe e gjobës |
| 114/a | Shfrytëzimi në rrethana rënduese, përfshirja e të miturve, shtytja, shtrëngimi për t'u marrë me prostitucion jashtë shtetit, kryerja në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose e personave të ngarkuar me funksione shtetërore e publike | 7-15 vjet burgim |
| 114/b | Rekrutimi, transporti, mbajtja e femrës përmes kërcënimit ose forcës, apo nëpërmjet formave të tjera të presionit, ose dhënia apo marrja e pagesës apo përfitimeve të tjera nga një person, i cili kontrollon një tjetër, për qëllime shfrytëzimi për prostitucion, apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, punë apo shërbime të tjera të detyruara, për qëllime të transplantit të organeve apo të formave të tjera të shfrytëzimit | 7-15 vjet burg dhe gjobë nga 3-5 milionë lekë |
| | Organizimi, menaxhimi dhe financimi i trafikut të femrave | Burgim 10-15 vjet dhe gjobë nga 5-7 milionë lekë |
| | Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose me shumë se një herë, ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin e saj | Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milionë lekë |
| | Ka sjellë si pasojë vdekjen e personit të trafikuar | Jo më pak se 20 vjet burg |
| | Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike | Një e katërta shtesë e burgimit dhe e gjobës |
| 128/b | Rekrutimi, transporti, strehimi ose marrja e fëmijës, për qëllime shfrytëzimi për prostitucion apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë apo shërbime të detyruara, forma skllavëruese apo të tjera të ngjashme me të, transplatimi i organeve, si dhe çdo formë tjetër shfrytëzimi | 7-15 vjet burg dhe gjobë nga 4-6 milionë lekë |
| | Organizimi, menaxhimi dhe financimi i trafikut të fëmijëve | 10-20 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milionë lekë |
| | Në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, ose shoqërohet me keqtrajtimin ose detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit si dhe kur ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e fëmijës së trafikuar | Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milionë lekë |
| | Ka sjellë si pasojë vdekjen e fëmijës | Jo më pak se 20 vjet burg dhe gjobë nga 8-10 milion lekë |
| | Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike | Një e katërta shtesë e burgimit dhe e gjobës |
| 297 | Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror | Gjobë ose burgim gjer në 2 vjet. |
| 298 | Dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit nëpërmjet vënies në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo i mjeteve të tjera për të ndihmuar kalimin e paligjshëm të kufirit | 1-4 vjet burg dhe gjobë 3-6 milionë lekë |
| | Dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit me qëllim fitimi | 3- 7 vjet burgim dhe gjobë nga 3-6 milionë lekë |

| | | |
|-----|--|---|
| | Në bashkëpunim, ose më shumë se një herë duke shkaktuar dëmtime serioze | 5-10 vjet burgim dhe gjobë nga 6-8 milionë lekë |
| | Kur shkaktën vdekjen | Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë 8-10 milionë lekë |
| | Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike | Një e katërta shtesë e burgimit dhe e gjobës |
| 109 | Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar autorët ose bashkëpunëtorët në largimin nga vendi i ngjarjes, për t'iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër | 10-20 vjet burgim |
| | Rrëmbimi ose mbajtja peng e fëmijët nën 14 vjeç | Jo më pak se 15 vjet burgim. |
| | Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e fëmijës nën 14 vjeç i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë | Jo më pak se 20 vjet burgim |
| | Kur është shkaktuar vdekja e personit | Burgim të përjetshëm |

IX. Monitorimi i strategjisë së trafikut të fëmijëve dhe planit të punës

Përgjegjësinë për kontrollin e zbatimit të Strategjisë kombëtare dhe planit të punës kundër trafikut të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime të trafikut, do ta ketë Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, i drejtuar nga Ministri i Shtetit për Koordinimin.

Grupi i punës për luftën kundër trafikut të fëmijëve dhe çdo ministri apo institucion që ka detyrime sipas kësaj strategjie të informojë për ecurinë e punëve të zbatimit të strategjisë, Ministrin e Shtetit dhe Komitetin e Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore çdo tre muaj nga data e miratimit të strategjisë dhe planit të punës në Këshillin e Ministrave.

Kryeministri do të informohet periodikisht për zbatimin e detyrave të strategjisë dhe planit të punës.

X. Tregues i shkurttimeve të përdorura në strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, viktime të trafikut:

| | |
|--------|--|
| MRP | Ministria e Rendit Publik |
| MPCŞ | Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe e Shkencës |
| MSH | Zyra e Ministrit të Shtetit për Koordinim |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| MPVD | Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| DPPSH | Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit |
| ICITAP | Programi Ndërkombëtar i Ndihmës në Trajnimin për Hetimin e Krimeve |
| OJF | Organizata jofitimprurëse vendase |
| OJQ | Organizata joqeveritare ndërkombëtare |

PLANI I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKUT

1. PARANDALIMI

Të vlerësohet aftësia e masave aktuale për kontrollin e kufijve në lidhje me fëmijët e shoqëruar apo të pashoqëruar, dhe të përmirësohet nëpërmjet trajnimit apo masave të tjera kapaciteti i policisë kufitare për të zbuluar dhe ndaluar trafikimin e fëmijëve dhe trafikantët, si dhe për të ofruar mbrojtje fillestare për fëmijët e trafikuar.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Të bëhet trajnimi i personelit të policisë kufitare për identifikimin dhe parandalimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve, si dhe për njohjen e tyre me konventat ndërkombëtare të nënshkruara dhe të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për trafikun e fëmijëve;

Kryejnë MRP, DPPSH me program të veçantë

Në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri në dhjetor 2005

- Të merren masat për regjistrimin në një *data base* të veçantë për të gjithë fëmijët që hyjnë dhe dalin nga vendkalimet kufitare të shoqëruar ose të pashoqëruar nga prindërit;

Kryejnë MRP, DPPSH

Afati deri në dhjetor 2005

- Të sigurohet bashkëpunimi formal dhe *ad-hoc* ndërkufitar me vendet fqinje dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në këto vende, si dhe ndërmjet strukturave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-të.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Të rishikohen marrëveshjet bilaterale të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, duke u fokusuar në problemet e parandalimit të trafikimit të fëmijëve;

Kryejnë MRP, DPPSH, MPJ

Afati deri në dhjetor 2005

- Të lidhen marrëveshje të reja atje ku nuk ekzistojnë, veçanërisht me vendet fqinje, lidhur me parashikimin e bashkëpunimit në drejtim të identifikimit të fëmijëve të trafikuar dhe që shfrytëzohen, për identifikimin e trafikantëve, mbledhjen dhe shkëmbimin sistematik të informacionit mbi trafikimin e fëmijëve, metodat dhe rrugët e përdorura dhe koordinimin e masave ndaj fenomenit, duke përfshirë edhe procedura të rregulluara për riatdhesimin në kufi;

Kryejnë MRP, DPPSH, MPJ

Afati deri në qershor 2006

- Të forcohet bashkëpunimi *ad-hoc* kufitar, veçanërisht me vendet fqinje për shkëmbimin e informacionit për trafikun e fëmijëve dhe parandalimin e tij;

Kryejnë MRP, DPPSH,

Afati deri në shtator 2005

- Të organizohen seminare dhe vizita pune për të shkëmbyer eksperiencën ndërmjet forcave policore të vendeve të tjera, të përfshira në luftë kundër trafikut të fëmijëve

Kryejnë MRP, DPPSH, MPCS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në dhjetor 2005

- Të sigurohet vendosja e kontakteve me strukturat analoge për mbrojtjen e fëmijëve shqiptarë të trafikuar në vendet e destinacionit, veçanërisht atje ku ka kontingjente të konsiderueshme, duke bashkëpunuar me strukturat shtetërore homologe, OJF-të shqiptare, të vendeve të destinacionit dhe organizatat ndërkombëtare;

Kryejnë MRP, DPPSH, MPCS, MPJ

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në dhjetor 2005

Hartimi i një programi masash në bashkëpunim me median, strukturat qeveritare dhe joqeveritare për ndërgjegjësimin e publikut.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Ndërgjegjësimi i publikut për rreziqet dhe dënimet që shoqërojnë këtë formë specifike të trafikimit nëpërmjet: përfshirjes së problemeve të trafikut të fëmijëve dhe pasojave të tij, në kurrikulat mësimore; nxitjen dhe stimulimin e veprimtarisë letraro-artistike që ka në qendër problemet e trafikut të fëmijëve, spoteve dhe emisioneve televizive, posterave, fletë-palosjeve etj., organizimi i kësaj fushate duke u fokusuar në komunitetet me vulnerabel;

Kryejnë MSH, MPÇS, MASH

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

- Shpërndarje informacioni dhe trajnime për zyrtarë të policisë antitrafik, policisë kufitare, doganave, personelit arsimor, shërbimeve sociale etj.;

Kryejnë MRP, DPPSH, MPÇS, PP, DPDoganave, MASH

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri në dhjetor 2005

- Vazhdimi i zbatimit të programit të përbashkët të MASH me IOM për trajnimin e mësuesve mbi trafikun e fëmijëve dhe pasojave të tij;

Kryejnë MASH, MSH

Afati në vazhdimësi

Instruktimi dhe trajnimi në nivel lokal i personelit të policisë, arsimit, punonjësve socialë, prokurorisë dhe OJF-ve të specializuara.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Të zhvillohen seminare me këtë pjesëmarrje lidhur me identifikimin dhe raportimin mbi fëmijët e humbur apo në rrezik trafikimi, si dhe të vlerësohen fëmijët në rrezik (dhe familjet e tyre) dhe të raportohen këto raste;

Kryejnë MRP, DPPSH, MPÇS, MASH, MSH, PP

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në dhjetor 2005

- Të ngrihen grupe pune në njësitë qendrore (prefektura) të pushtetit vendor me pjesëmarrje të punonjësve të këtyre njësive (administratorë socialë dhe punonjës të gjendjes civile) arsimit, rendit, prokurorisë, organizata joqeveritare dhe të hartohen programe për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe masat parandaluese për fëmijët në rrezik trafikimi;

Kryejnë MRP, MPVD, MASH, MSH

Afati deri në dhjetor 2005

- Të ndërmerren masa të mirëkoordinuara zyrtare për të hetuar dhe parandaluar rastet e zhdukjes së fëmijëve dhe të hartohen procedurat për riintegrimin arsimor për fëmijët dhe/ose kurse trajnimi profesionale për fëmijët që nuk ndjekin shkollën dhe janë në rrezik trafikimi.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Rritja e ndërgjegjësimit për arsimimin e detyruar dhe forcimin e masave ndëshkuese për prindërit që nuk mundësojnë dërgimin e fëmijëve në shkollë;

Kryejnë MASH dhe MPV

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati në vazhdimësi

- Institucionet arsimore lokale të bëjnë identifikimin e fëmijëve që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm dhe të ngrenë në nivel prefekturë strukturat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e ligjit;

Kryejnë MASH dhe MPV

Afati deri në shtator 2005

- Të organizohen aktivitete të veçanta arsimimi/edukimi për fëmijët me prindër të divorcuar ose me një prind dhe me probleme ekonomiko-sociale në familje;

Kryejnë MASH, MPV

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në nëntor 2005

- Krijimi i një strukture brenda prokurorisë për fëmijët, hetimin e rasteve të fëmijëve të zhdukur, duke bashkëpunuar me MASH, MPÇS dhe MRP;
Kryejnë PP, MASH, MPÇS, MRP
Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të
Afati deri në shtator 2005
- Të organizohen aktivitete edukative për fëmijët me prindër të divorcuar ose fëmijët me një prind, ku familjet përballen me probleme social-ekonomike;
Kryejnë MASH, MPV
Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të
Afati deri në dhjetor 2005
- Shtirja e klasave të integruara me programe të veçanta të arsimit bazë dhe tërheqja në to e fëmijëve që e kanë braktisur shkollën ose nuk e kanë ndjekur atë, veçanërisht fëmijët e komuniteteve si romët dhe jevgjit, si dhe kategoritë e fëmijëve të rrugës;
Kryejnë MASH, MPV
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në shtator 2005
- Marrja e masave për të inkurajuar tërheqjen e vajzave në arsimin e mesëm, veçanërisht në zonat rurale;
Kryejnë MASH, MPV, MSH
Afati 2005 e në vazhdim
- Të ofrohen kurse profesionale për adoleshentët, të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike, sidomos për jetimët dhe vajzat që kanë braktisur shkollën, sipas modelit të qendrave të formimit profesional të ngritura në Tiranë, Fier dhe Elbasan;
Kryejnë MASH, MPV, MPÇS
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në dhjetor 2005
- Të krijohet një sistem informacioni për punësimin, i cili do të ndihmojë në publikimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese, formate projektesh, përvojash, si dhe informacione për burimet financiare dhe teknike për nxitjen e punësimit të adoleshentëve, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të;
Kryejnë MPV, MPÇS
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në shtator 2005
- Të nxiten organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të për financimin e projekteve me synim ngritjen e aktiviteteve prodhuese familjare, shembull i projekteve të mbështetura nga Shërbimi Social Ndërkombëtar, mbështetur në Shqipëri nga ai italian;
Kryejnë MPV, MPÇS
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në dhjetor 2005
- Të ngrihet niveli ekonomik i familjeve të grupeve të marginalizuara, veçanërisht komunitetit rom, përmes përfshirjes në programet e nxitjes së punësimit, mbështetjes me bazë materiale, mjedise, mjete financiare dhe burime njerëzore për zhvillimin e atyre bizneseve që kanë si destinacion produktet e traditës së artizanatit;
Kryejnë MPÇS, MASH
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati 2005 e në vazhdim
- Të nxitet dhe të ndihmohet ngritja e qendrave ditore dhe shërbimet komunitare për integrimin e fëmijëve romë në procesin e edukimit dhe në parandalimin e rrezikut të trafikimit;
Kryejnë MPÇS, MASH
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati 2005 e në vazhdim

- Të ushtrohet kontroll sistematik nga Inspektorati Shtetëror i Punës për punën e zezë të fëmijëve në përgjithësi dhe të fëmijëve romë në veçanti, dhe të merren masat e nevojshme për parandalimin e saj;

Kryen MPÇS

Afati 2005 e në vazhdim

- Përmirësimi i kushteve të institucioneve publike dhe jopublike të përkujdesjes për fëmijë, rritja e kërkesës për mirërritjen dhe përgatitjen e fëmijëve për integrimin e tyre në jetë. Pasqyrimi i kërkesave të reja në rregulloret e funksionimit të këtyre institucioneve;

Kryejnë MPÇS, MASH

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

- Përgatitja e një udhëzimi metodologjik dhe organizimi i trajnimeve për ekipin multi-disiplinor të angazhuar në përgatitjen e integritit social dhe profesional të fëmijëve të përfshirë në sistemin e institucioneve të përkujdesit për fëmijët;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në qershor 2005

2. MBROJTJA E VIKTIMAVE

Të garantohet akomodimi në qendrat pritesë, strehëzat (shelter) për referimin fillestar të fëmijëve, viktimat të trafikimit, si dhe ata të ndaluar gjatë trafikimit, për t'i përgatitur për rikthim në familje ose në mjedise të tjera alternative mbrojtëse, për rastet kur kthimi pranë familjeve nuk është i këshillueshëm apo i mundshëm.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Hartimi i rregullores për zbatimin e procedurave të pritjes, transferimit të fëmijëve, viktimat të trafikut nga pikat e kalimit kufitar, në rastin e arrestimit apo kthimit;

Kryejnë MPÇS, MRP

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në qershor 2005

- Të ngrihen ambiente të veçanta me infrastrukturën e nevojshme në pikat e kalimit të kufirit, për pritjen dhe strehimin e fëmijëve të trafikuar, para se ata të mbërrijnë në familje apo qendrat pritesë;

Kryejnë MRP, DPPSH, MPÇS

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri në shtator 2005

- Të vendosen standardet për procedurat fillestare të përkujdesjes ndaj fëmijëve, viktimat të trafikut, të cilat duhet të zbatohen si nga sektori publik ashtu dhe nga institucionet private të përkujdesjes së fëmijëve strukturat e tjera për mbrojtjen e fëmijëve, autoritetet në fushën e drejtësisë, e gjithë kjo bazuar në interesin më të mirë të fëmijës;

Kryejnë MPÇS, MSH, PP

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri me qershor 2005

- Të përmirësohet kapaciteti i Qendrës Kombëtare Pritëse për pritjen dhe strehimin e fëmijëve, viktimat të trafikut;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri më qershor 2005

- Krijimi i ekipeve të specializuara dhe ambienteve të veçanta për grup-mosha të ndryshme, brenda Qendrës Kombëtare Pritëse për viktimat e trafikut;

Kryen MPÇS

Afati deri në shtator 2005

- Rritja e nivelit profesional të stafit të punonjësve socialë përgjegjës për trajtimin e fëmijëve, viktimat të trafikut, nëpërmjet programeve të formimit profesional dhe trajnimeve për problemet e pritjes dhe intervistimit të fëmijëve viktimat të trafikut, të trajtimit psiko-social të

viktimave, për rolin e kujdestarisë etj.;

Kryen MPÇS

Afati deri në qershor 2005

- Të hartohen rregulloret për unifikimin dhe zbatimin e procedurave fillestare të pritjes, intervistimit, ruajtjes së informacionit në lidhje me fëmijët, viktimat e trafikut, në përputhje me programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe rolin multi-funksional të Qendrës Kombëtare Pritëse për viktimat e trafikut;

Kryejnë MPÇS, MRP, PP

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri më qershor 2005

- Të negociohen dhe nënshkruhen marrëveshjet e nevojshme të bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë dhe Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, organizatat ndërkombëtare, OJF-të të (ku përfshihen Qendra "Vatra, Terre des Hommes, UNICEF-i, IOM, ILO dhe anëtarët e tjerë të BKTF (Bashkë Kundër Trafikut të Fëmijëve), për zbatimin e një procesi të unifikuar për pritjen, mbrojtjen dhe procedurat e riintegritit për fëmijët, viktimat e trafikut;

Kryejnë MPÇS, MRP, PP, MSH

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri në qershor 2005

- Të hartohen programe integrimi dhe riintegrimi nga qendrat e pritjes për fëmijët që do të qëndrojnë për një kohë të gjatë në to;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në qershor 2005

- Të nxitet dhe të mbështetet shërbimi i përhershëm apo i përkohshëm i kujdestarisë për fëmijët që kthehen nga trafikimi ose janë në rrezik trafikimi, kur prindërit kanë humbur zotësinë prindërore, përkohësisht ose përgjithmonë;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati qershor 2005 e në vazhdimësi

- Të nxitet, të mbështetet dhe të standardizohet shërbimi i kujdestarisë duke shfrytëzuar modelet e krijuara nga ofrimi i këtij shërbimi të ri nga disa OJF;

Kryen MPÇS

Afati deri në shtator 2005

- Të bashkëpunohet me OJF-të e specializuara që ofrojnë shërbimet e kujdestarisë, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe kontratave;

Kryejnë MPÇS, MSH

Afati deri në shtator 2005

- Të merren të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur sigurinë e fëmijës, duke përfshirë këtu ruajtjen e çdo informacioni, që mund të zbulojë identitetin e fëmijës apo të anëtarëve të tjerë të familjes;

Kryejnë MPÇS, MRP

Në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme

Afati në vazhdimësi

Të zhvillojë modele mbrojtjeje dhe riintegriti për viktimat aktuale apo të ardhshme të trafikimit të fëmijëve që janë jetimë ose që për arsye të tjera nuk mund të kthehen pranë familjeve të tyre.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Të rishikohet rregullorja e institucioneve të përkujdesit për fëmijët jetimë, ku të përcaktohen detyrimet për zbatimin e procedurave të birësimit apo shërbimit të kujdestarisë;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

- Sigurimi i masave të veçanta dhe procedurat për riintegrimin e fëmijëve të trafikuar apo fëmijëve jetimë në rrezik, në përputhje me të drejtat dhe nevojat e tyre specifike;

Kryen MPÇS

Afati deri në qershor 2005

Organizimi i trajnimeve me përfaqësuesit e strukturave shtetërore, të pushtetit vendor dhe të institucioneve publike dhe jopublike, të angazhuara për mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve të trafikuar apo në rrezik, për njohjen e legjislacionit shqiptar për fëmijët, të konventave të tjera të njohura ndërkombëtare dhe udhëzimeve të UNICEF-it; për menaxhimin e qendrave pritëse dhe integruese; për standardet e trajtimit dhe kujdesit për fëmijët; për problemet e kujdestarisë, birësimit dhe rehabilitimit.

Për zbatimin e këtij objekti të merren këto masa:

- Organizimi i kurseve të trajnimit dhe formimit profesional, afatmesëm dhe afatgjatë me punonjësit socialë që të realizojnë funksione të specializuara të kujdesit për fëmijët, të parashikuara në aktivitetet e përmendura më sipër, si dhe me punonjësit e strukturave shtetërore qendrore dhe të pushtetit vendor që ndjekin këto probleme;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati shtator 2005 e në vazhdimësi

Ofrimi i shërbimeve të reja për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave aktuale apo të mundshme të trafikimit, nga institucionet e shërbimeve sociale publike e jopublike, të ndihmuara nga OJF-të, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.

Për zbatimin e këtij objekti do të merren këto masa:

- Krijimi i ekipeve të lëvizshme (mobile) të ndihmës me përfaqësues nga strukturat e zbatimit të ligjit, të OJF-ve, të shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të ndihmuar në referimin fillestar të fëmijëve dhe strehimin e tyre;

Kryejnë MPÇS, MRP, MPV

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

- Krijimi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës pranë njësive të pushtetit vendor, të përbërë nga përfaqësues në fushën e mjekësisë, arsimin, shërbimit social, rendit, prokurorisë, punonjësve lokalë, si dhe nga përfaqësues të sektorit joqeveritar, përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimit të trafikut;

Kryejnë MPÇS, MSH, MRP, MPV

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në dhjetor 2005

- Të trajnohen strukturat e përmendura më sipër në nivel qendror dhe prefekturë;

Kryejnë MPÇS, MRP, MPV

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri më qershor 2006

- Monitorimi dhe ndjekja e rasteve të birësimit, kujdestarisë dhe riintegrimin;

Kryejnë MPÇS, Komiteti i Birësimit

Afati në vazhdimësi dhe rast pas rasti

- Sigurimi i ndihmës ekonomike apo i formave të tjera të ndihmës për familjet kujdestare apo familjet biologjike, veçanërisht për rastet kur këto të fundit nuk janë të implikuara në trafikim dhe kur fëmijët e tyre kanë denoncuar trafikantët;

Kryen MPÇS

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati në vazhdimësi dhe rast pas rasti

3. HETIMI DHE DËNIMI I TRAFIKANTËVE

Të përmirësohen procedurat për identifikimin dhe zbulimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve, ndjekja penale dhe dënimi i autorëve të veprave penale që lidhen me të.

Për kryerjen e këtij objekti do të merren këto masa:

- Realizimi i bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe lokal, ndërmjet strukturave të shërbimit social, mbrojtjes, rendit, ligjit dhe OJF-të e specializuara, për shkëmbimin e informacionit, kur dyshohet se fëmija është trafikuar dhe shfrytëzuar ose është në rrezik;

Kryejnë MPÇS, MRP

Në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithëshme, OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati në vazhdimësi

- Të përzgjidhen dhe të trajnohen oficerë policie, prokurorë dhe gjykatës, të caktuar për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të trafikut të fëmijëve;

Kryejnë MRP, MD, PP

Afati shtator 2005 dhe në vazhdimësi

- Ngritja dhe funksionimi i seksioneve të të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të vendit, si dhe funksionimi i sektorëve të veçantë për hetimet ndaj të miturve, pranë Drejtorive të Hetimit dhe të Kontrollit të Ndjekjes Penale në prokurori;

Kryejnë MD, PP MRP

Afati deri në shtator 2005

- Zbatimi i një qëndrimi unik për mbrojtjen e dëshmitarëve në çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, viktimat të trafikimit, nëpërmjet marrjes së masave të përshtatshme për krijimin e strukturave institucionale, të cilat bashkëpunojnë për realizimin e njohjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve gjatë hetimeve dhe procesit gjyqësor, duke pasur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës;

Kryejnë MRP, PP, MD

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati dhjetor 2005 dhe në vazhdimësi

- Të sigurohet se organet e rendit dhe prokurorisë të kenë informacion të mjaftueshëm për fëmijët, viktimat të trafikut, duke marrë parasysh moshën, të drejtat e tyre në përputhje me legjislacionin vendas dhe instrumentet/ndërkombëtare, para se ata të vendosin nëse do të dëshmojnë ose jo për trafikantin apo shfrytëzuesin e tyre;

Kryejnë MRP, PP, MD

Afati në vazhdimësi dhe rast pas rasti

- Sigurimi i asistencës psiko-sociale dhe i mbrojtjes së të drejtave ligjore të fëmijëve viktimat, në rastet kur ata vendosin të mos denoncojnë personat që i kanë trafikuar apo shfrytëzuar;

Kryejnë MRP, PP, MPÇS, MD

Afati në vazhdimësi dhe rast pas rasti

- Marrja e masave për të garantuar të drejtën e fëmijëve për t'u kthyer pranë familjes, qendrave të pritjes apo atyre të kujdestarisë, pas intervistimit të tyre nga ana e policisë gjyqësore;

Kryejnë MRP, PP, MPÇS

Afati në vazhdimësi

- Ruajtja e fshehtësisë së informacionit mbi fëmijët viktimat, i cili mund të sjellë fëmijët ose ndonjë anëtar të familjes së tyre në rrezik;

Kryejnë MRP, PP

Afati në vazhdimësi

4. KTHIMI VULLNETAR I ASISTUAR I TË MITURVE VIKTIMA

Të rregullohen dhe financohen procedurat e kthimit vullnetar të asistuar të fëmijëve, viktimat të trafikut:

Për realizimin e këtij objekti do të merren këto masa:

- Negocimi i marrëveshjeve të reja apo të përmirësuara bilaterale me vendet fqinje apo vendet e tjera të destinacionit dhe transitimit, veçanërisht me Greqinë dhe Italinë, për njoftimin reciprok, akomodimin e sigurt dhe kthimin e rregullt dhe të koordinuar të fëmijëve, viktimat të trafikimit, nëpërmjet proceseve dhe procedurave që respektojnë të drejtat dhe interesat e fëmijëve dhe perspektivat e tyre për riintegrim social;

Kryejnë MPJ, MRP, MPÇS

Afati deri në shtator 2005 dhe në vazhdimësi

- Hartimi i standardeve për riatdhesimin e fëmijëve, viktimat të trafikut, nëpërmjet kthimit vullnetar të asistuar të tyre, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve, të drejtës së fëmijës për të vendosur të kthehet ose jo në familjen, vendin e tij të origjinës, në përputhje me standardet ndërkombëtare për riatdhesimin (Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e Kombeve të Bashkuara);

Kryejnë MPÇS, MRP

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

- Krijimi i një strukture në nivel qendror që do të trajtojë problemet e mbrojtjes dhe kthimit vullnetar të asistuar të fëmijëve (Autoriteti përgjegjës), viktimat të trafikut apo në rrezik trafikimi dhe koordinimit të procedurave të partnerëve vendas me strukturat përkatëse qeveritare, OJF-të, organizatat ndërkombëtare në vendet kryesore të destinacionit, dhe veçanërisht me Greqinë dhe Italinë;

Kryejnë MPÇS, Komiteti për Mundësi të Barabarta në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri më qershor 2005

- Zbatimi i projekteve për identifikimin dhe kthimin vullnetar të asistuar të fëmijëve shqiptarë që gjenden të pashoqëruar në Itali dhe Greqi, duke u mbështetur në eksperiencën e fituar;

Kryejnë MPÇS, MRP

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati në vazhdimësi

- Të përgatiten me asistencën e OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare fletëpalosje apo buletine dhe t'u shpërndahen fëmijëve viktimave brenda dhe jashtë vendit, me informacion mbi statusin, situatën, të drejtat e tyre dhe shërbimet që u ofrohen për ribashkimin me familjen, si dhe procesin e riatdhesimit;

Kryejnë MPÇS, MPJ, MSH

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

- Instruktimi i përfaqësuesve të shërbimit konsullor shqiptar mbi verifikimin e të dhënave, mënyrën e lëshimit të dokumenteve të udhëtimit në kohë për fëmijët që mund të riatdhesohen;

Kryen MPJ

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri në shtator 2005

Instruktimi dhe trajnimi i personelit konsullor shqiptar për të aplikuar procedurat e njohura ndërkombëtare për mbrojtjen dhe njoftimin në organet kompetente për fëmijët shqiptarë të trafikuar apo në rrezik shfrytëzimi në vendet pritëse;

Kryen MPJ

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të

Afati deri në shtator 2005

- Informimi dhe trajnimi i personelit të zyrave të gjendjes civile për lëshimin e të dhënave të kërkuara për një fëmijë (kur, si dhe kujt duhet t'i jepet informacioni);

Kryen MPV

Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare

Afati deri në shtator 2005

5. KOORDINIMI I PARTNERËVE ANTITRAFIK

Për realizimin e këtij objekti do të merren këto masa:

- Krijimi në nivel qendror dhe lokal i një strukture për mbrojtjen e fëmijëve që do të koordinojë dhe mbikëqyrë aktivitetet lokale dhe kombëtare për arsimin, shëndetin dhe shërbimet sociale, rendin, ndjekjen penale, strukturat e pushtetit vendor, dhe të bashkëpunojë me organizatat dhe OJF-të përkatëse për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga plani i punës;

Kryejnë MPÇS, MPV, MASH, MRP, DPPSH, PP, MSH
Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të
Afati deri më shtator 2005

- Krijimi i një rrjeti partneriteti për luftën kundër trafikut të fëmijëve në nivel rajonal dhe vendor (qarqesh e bashkish), me pjesëmarrës nga OJF-të dhe përfaqësues të shërbimeve sociale, mjekësore, arsimore, policore dhe të prokurorisë në nivel lokal, me qëllim asistimin dhe këshillimin e viktimave dhe familjeve dhe koordinimin e shërbimeve shtetërore në nivel kombëtar me shërbimet e OJF-ve, të organizatat ndërkombëtare, strehëzat dhe institucionet e tjera mbrojtëse;

Kryejnë MPÇS, MPV, MRP, Prokuroria
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në dhjetor 2005

- Negocimi i memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve të angazhuara në luftën kundër trafikimit të fëmijëve, parandalimin dhe mbrojtjen e tyre dhe OJF-ve vendase dhe organizatave ndërkombëtare, për të rregulluar dhe përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve, në interes të transparencës dhe të mbrojtjes ligjore reciproke të përfituesve dhe atyre që asistojnë këta të fundit;

Kryejnë MSH, MPÇS
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në qershor 2005

- Nxitja e koordinimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar ndërmjet OJF-ve që merren me trafikimin e fëmijëve, qendrave pritëse, “hot line” dhe institucioneve të tjera respektive në Shqipëri me homologët e tyre në vendet fqinje dhe ato të destinacionit, me qëllim zbatimin e politikave dhe masave të përshkruara më sipër, veçanërisht të atyre që lidhen me riatdhesimin vullnetar të asistuar;

Kryejnë MPJ, MRP, MPÇS, MSH
Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të
Afati deri në dhjetor 2005

- Krijimi një sistemi komprensiv dhe të koordinuar për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit (të dhënat) për trafikimin e fëmijëve, bazuar në një metodologji të aprovuar nga të gjithë partnerët shtetërorë, OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare;

Kryejnë MPÇS, MSH
Në bashkëpunim me OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare
Afati deri në shtator 2005

KËRKESË

Shtetësja Hane Gjuzi e datëlindjes 1955, lindur dhe banuese në Durrës, kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të saj, shtetasit Enkeleid Gjuzi, i datëlindjes 18.2.1973.

KËRKUESE
Hane Gjuzi

Ndrejje gabimi

Në ligjin nr.9354 datë 3.3.2005 “Për përcaktimin e zonave zgjedhore” bëhet korrigjimi i mëposhtëm sipas këtij teksti:

“Qendra e Votimit nr.3649 kalon nga Zona Zgjedhore nr.81 në Zonën Zgjedhore nr.80.

Totali i Zonës Zgjedhore nr.80 shkon 25 550 zgjedhës me devijim+9.33%, kurse Zona Zgjedhore nr.81 respektivisht 22 554 zgjedhës dhe -3.48.”.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 13.4.2005

| | |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë